



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS
SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE**

PROJEKT VENDIM
Nr. 05 datë 13 /06.2025

Mbi "Dhënien e ndihmës financiare të menjëhershme familjes së shtetasit Pjeter Mirash Gjoni i dëmtuar nga zjarri me dt.16.05.2025 banorë i Bashkisë Vau-Dejës"

Bazueshmëria ligjore e vendimit të propozuar është:

Ligji Nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligji Nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile", neni 41, VKM-së Nr.329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", pika 3, Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave, Nr.263, datë 24.05.2013 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore, financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", Udhëzimi Nr.3 dt.28.12.2016 "Për miratimin e kostos së ndërtimit të banesave nga enti kombëtar i banesave për vitin 2016" si dhe në shkresën Nr.373/1 dt.17.05.2016 të Prefekturës së Qarkut Shkodër "Në lidhje me çmimet e mobiljeve, orendive dhe pajisjeve elektroshtëpiake të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve,"

Për sa më sipër, Kryetari i Bashkisë Vau - Dejës për të përballuar dëmet e shkaktuara nga zjarri i rënë në banesën e shtetasit **Pjeter Mirash Gjoni** me dt.16.05.2025 që është banorë i fshatit Fshat i Ri të Njesisë Administrative Bushat të Bashkisë Vau-Dejës, i propozon Këshillit Bashkiak që me shumicë votash:

V E N D O S I :

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Vau Dejës për ndihmën e menjëhershme financiare familjes së **z.Pjeter Mirash Gjoni** (4 anëtarë në familje), në vlerën **80.000**(tetëdhjetë mijë) lekë për dëmtimin plotësisht të banesës së tij nga zjarri .
2. Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Vau Dejës , për familjen e **z.Pjeter Mirash Gjoni** në vlerën totale të dëmit **4.841.703** (Katërmilion e tetëqind e katërdhjetë e një mijë e shtatëqind e tre) lekë.
3. Të miratojë dhënien e kompensimit sipas proces verbalit të vlerësimit i hartuar nga grupi i verifikimit dhe vlerësimit, në masën **50%** të vlerës totale në shumën **2.420.851.⁵** (dymilion e katerqind e njezet mijë e tetëqind e e pesëdhjetë e një pikë pesë) lekë.
4. **Efektet:** Krijon lehtësira për përballimin e situatës emergjente të banorit të dëmtuar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

5. **Burimi i financimit** do të jetë pjesërisht fondi i kushtëzuar i vitit 2025 sipas shkresës nr.492/1 dt.25.02.2025 e protokolluar nga ana jonë me shkresën nr.991 prot dt.27.02.2025 “Mbi fondin e kushtëzuar të Buxhetit të shtetit për programin e Mbrojtjes Civile” në masën 1.500.000 (një milion e pesëqind mijë) leke ndërsa pjesa e mbetur prej 1.000.851.⁵ (një milion e tetëqind e pesëdhjetë e një pike pesë) është fondi i Bashkisë i planifikuar për programin e Mbrojtjes Civile i miratuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.84 dt.23.12.2024” Mbi miratimin e buxhetit 2025” konfirmuar nga Prefektura Shkodër me shkresën 860/1 dt.06.01.2025.

Konfirmoi bazen ligjore

Konfirmoi bazen financiare

Konceptoi

Valjeta NIKAJ

KRYETARI

Kristian SHKRELI

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZV/KRYETARI

Aleksandra GJONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS

Numri-i praktikës: 1073
Vau Dejës, me: 19/05/2025

KËRKESE

Unë i/e nenshkruari/a Pjeter Mirash Gjoni me numër personal F40813116V; banues në Fshat i Ri Njesia Administrative Bushat, dhe numer celulari 0693907423, në bazë të ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" dhe Kodit të Proçedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë i drejtohem Sektori i Emergjencave Civile të Bashkisë Vaut Dejës me kërkesën e mëposhtme;

KËRKOJ

Une Pjeter Gjoni banor i fshatit Fshat i Ri, ditën e premte me dt 16-05-2025 si pasoje e nje shkendije elektrike me eshte djegur e gjithë banesa duke me shkaktuar dëme te medha, kërkoj nga ana e Bashkise Vau Dejes te behen verifikime ne terren.

Aplikanti

Specialisti i Zyrës me Një Ndalesë

Pjeter Gjoni

Selenja Nilaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

SEKTORI I MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMI

Nr. 2325/Prot.

Vau-Dejës, me 20/05/2025

VËRTETIM

Për rënie zjarri

Vërtetohet me datë 16/05/2025 në orën 06²¹ jemi njoftuar për zjarr në shtëpi banimi. Zjarri ishte në një banesë një katëshe me çati, e përbërë nga tre dhoma, koridor dhe banjo, me pronar Pjeter Gjoni me adresë Fshati i Ri (Trush i Poshtem), Njesia Administrative Bushat, Bashkia Vau-Dejës. Si pasojë e zjarrit të rënë në banesën 1 (një) katëshe me çati banesa është djegur plotësisht me të gjitha orënditë e saj që kishte mbrenda. Për fikjen e zjarrit morën pjesë personeli i MZSH-së i stacionit të Vau-Dejës me komandant turni Luendro Guri, me 2 (dy) automjete zjarrfikës dhe 8 efektive. Stacioni i MZSH-së disponon dokumentacionin përkatës që vërteton rënien e këtij zjarri. Ky vërtetim mbahet në 3 (tre) kopje dhe përpilohet me kërkesën e të interesuarve për ta përdorur sipas nevojave.

SHEFI SEKTORIT TË MZSH-së

Glen RROTANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJES
KRYETARI**

Nr. 2333 Prot

Vau Dejës: 20.05.2025.

URDHËR

Nr. 287 datë 20.05.2025

Për "Ngritje komisioni"

Mbështetur në ligjin Nr.45/2019 datë 18.07.2019 "Për mbrojtjen Civile", VKM-së Nr.329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", Udhëzimi Nr.1185/1 "Për kriteret, rregullat dhe procedurat e përdorimit të fondit të Emergjencave Civile planifikuar në buxhetin vjetor të Ministrisë së Punëve të Brendshme", i ndryshuar, për verifikimin e rasteve të dëmtimit nga zjarri dt.16.05.2025 në banesën e shtetasit **Pjeter Gjoni** banorë në fshatin Fshat i Ri të Njesisë Administrative Bushat të Bashkisë Vau Dejës sipas kërkesës me nr. Praktike 1073 dt.19.05.2025 .

URDHËROJ:

1. Ngritjen e komisionit të mëposhtëm për verifikimin e e rastit të dëmtimit nga zjarri të banesës së shtetasit Pjeter Gjoni banorë i Fshatit të Ri të Njesisë Administrative Bushat të Bashkisë Vau-Dejës
 - a. Valjeta Nikaj
 - b. Lazër Gjergji
 - c. Ardian Firza

Kryetare
Anëtar
Anetar
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhëri komisioni i lartpërmendur.
3. Afati për përpilimin e proces verbaleve të konstatimit dhe të vlerësimit të rasteve është data 23.05.2025.
4. *Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.*

KRYETARI

Kristian SHKRELI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU-DEJËS
SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE

Nr. 287/A Prot

Vau Dejës, me 20.05/2025

PROCES VERBAL KONSTATIMI

I Mbajtur sot me datë **20.05.2025** në fshatin Fshat i Ri të Njesisë Administrative Bushat të Bashkisë Vau-Dejës nga komisioni i ngritur me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë **Nr.287 dt.20.05.2025** për konstatimin e kërkesës me nr praktike 1073 së shtetasit **Pjeter Mirash Gjoni** mbi rënien e zjarrit në banesën e tij me dt.16.05.2025.

Gjatë verifikimit në vend u konstatua:

Banesa është ndërtesë 1 katëshe e ndërtuar në vitin 1991 ku janë 3 dhoma +kuzhinë+banjo +salon me sipërfaqe 113.4 m².

Zjarri ka rënë në banesën e shtetasit **Pjeter Mirash Gjoni** me dt.16.05.2025 ora 6.21(te mengjesit), ku fatmirësisht nuk ka humbje jetësh por lëndime të kryefamiljarit. Banesa është dëmtuar plotësisht nga ana ndërtimore. Gjithashtu janë dëmtuar plotësisht të gjitha mobiljeritë,orenditë dhe pajisjet elektro-shtëpiake si më poshtë:

Nr	Emertimi	Sasia (copë)
1.	Televizor Samsung 50 Pol	1
2.	Frigorifer LG gsp 325	1
3.	Frigorifer Samsung RS7778	1
4.	Sobe Gorenje	1
5.	Furre Gorenje	1
6.	Fshesa Gorenje	1
7.	Microvale Gorenje	1
8.	Aspirator Gorenje	1
9.	Kondicioner Vivax	1
10.	Lavatriçe Ariston	1
11.	Komplet kolltuqe	1
12.	Minibare kine	1
13.	Minibar	1
14.	Etazher	1
15.	Tavoline mesi	1
16.	Tavoline buke	1
17.	Tavoline kafe me xham	1
18.	Karrige me tapiceri	4
19.	Dhome gjumi matrimoniale	2
20.	Dyshek doppio	2

21.	Varese rrobash	2
22.	Mbajtese kepucesh	1
		28(cope)

Bashkëlidhur këtij proces verbali do të gjeni edhe kopjen e Planimetrisë së banesës së shtetasit **Pjeter Mirash Gjoni** banorë në fshatin Fshat i Ri të Njësisë Administrative Bushat të Bashkisë Vau-Dejës.

KOMISIONI

Valjeta Nikaj



Lazer Gjergji



Ardian Firza

MIRATO HET
KRYETARI
Kristian SHKRELI

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZV/KRYETARI

Aleksandra GJONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU-DEJES
SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE

Vau-Dejes, me 20.05.2025

MIRATOHET

KRYETARI
Kristian **SHKRELI**

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZV/KRYETARI
Aleksandra **GJONI**

Vlerësimi I dëmeve në mobileri, orendi, pajisje elektroshtepiake

Në mbështetje të V.K.M Nr. 329, datë 16/05/2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për ngjyrimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", vlerësimi I dëmeve sipas komisionit të vlerësimit për: mobileri ,orendi, pajisje elektro-shtëpiake të dëmtuara nga zjarri në objektin e banimit të **z.Pjeter Mirash Gjoni** është:

Nr	Emertimi	Sasia (lope)	Çmimi	Vlera
1.	Televizor Samsung 50 Pol	1	125.600	125.600
2.	Frigorifer LG GSP 325	1	140.880	140.880
3.	Frigorifer Samsung RS7778	1	85.200	85.200
4.	Sobe Gorenje	1	43.980	43.980
5.	Furre Gorenje	1	24.000	24.000
6.	Fshesa Gorenje	1	12.000	12.000
7.	Mikrovale Gorenje	1	39.600	39.600
8.	Aspirator Gorenje	1	18.840	18.840
9.	Kondicionere Vivac 8 INV	1	69.900	69.900
9.	Lavatriçe Ariston	1	57.000	57.000
10.	Komplet kolltuqe	1	48.300	48.300
11.	Minibare kine	1	38.000	38.000
12.	Minibar	1	32.000	32.000
13.	Etazher	1	11.000	11.000
14.	Tavoline mesi	1	10.000	10.000
15.	Tavoline buke	1	18.000	18.000
16.	Tavoline kafë me xham	1	9.800	9.800
17.	Karrige me tapiceri	4	2.200	8.800
18.	Dhome gjumi matrimoniale	2	155.000	310.000
19.	Dyshek doppio	2	13.100	26.200
20.	Varese rrobash	2	1.700	3.400
21.	Mbajttese kepucesh	1	7.600	7.600
Shuma				1.140.100

Vlerësimi i mobiljeve, orendive dhe pajisjeve elektroshtëpiake është bërë në bazë të shkresës Nr.373/1 dt.17.05.2016 të Prefekturës së Qarkut Shkodër "Në lidhje me çmimet e mobiljeve, orendive dhe pajisjeve elektroshtëpiake të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve"

Vlerësimi i zërave të punimeve është bërë në mbështetje të V.K.M Nr. 329, datë 16/05/2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", kapitulli III, pika 2 germa ç, si dhe Udhëzimin Nr.3 dt.28.12.2016 "Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga enti kombëtar i banesave për vitin 2016, tabela Nr.1 me vlerë **32.642 lek/m²** (pa TVSH), ku vlera e objektit të dëmtuar është **3.701.603 leke**

Vlera e objektit të dëmtuar është **3.701.603** lekë, ndërsa vlera e dëmeve në mobilje, orendi dhe pajisjeve elektroshtëpiake është **1.140.100** lekë, ku vlera totale e dëmit është **4.841.703** (katërmilion e tetwqind e katwrdhjetë e një mijë e shtatëqind e tre) lek e cila paguhet sipas Udhëzimit Nr.3 dt.28.12.2016 "Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga enti kombëtar i banesave për vitin 2016.

Komisioni:

Valjeta Nikaj



Lazer Gjergji



Ardian Firza



Relacion

Objekti:” Ndërtesë (banesë) 1 katëshe me çati +soletë”

Vendodhja : Fshati I RI,Nj.A, BUSHAT

Pronari:Z.Pjeter Mirash Gjoni

Banesa është përfshirë nga zjarri me date 16.05.2025 dhe si pasojë e kësaj ngjarje në banesë janë dëmtuar :

1. Çatia plotësisht
2. Mure bllok qeramike (Plasaritur ne strukture mure me tuula qeramike + kolona b/a + breza b/a)
3. Pllakat plotësisht
4. Dyert plotësisht
5. Dritare plotësisht
6. Tavani plotësisht
7. Instalime elektrike plotësisht
8. Instalime hidrosanitare plotësisht
9. Paisje dhe mobileri të ndryshme plotësisht

Nga verifikimet e grupit të punës dhe specialistave teknik në terren nga matjet e kryera rezulton që objekti, ndërtesë (banesë) 1 kateshe me pronar **Z.Pjeter Mirash Gjoni** me adresë **Fshati I Ri,Nj.Administrative BUSHAT** është i dëmtuar plotësisht dhe është bërë i pabanueshëm.

Objekti ka sipërfaqe prej **113.4 m²**.

Vlera sipas manualit dhe çmimeve referuese të Entit Kombëtar të banesave është **32.642 l/m²**.(pa TVSH), sipas udhëzimit Nr.3 dt.28.12.2016.”Për miratimin e koston së ndërtimit të banesave nga enti kombëtar i banesave”

Vlera totale e objektit të dëmtuar është :

Vlera =113.4 *32.642 =3,701,602.8 Leke (pa TVSH).

Punoi : Lazer Gjergji

GRUPI I PUNËS

Komisioni:

Ardian Firza

Valjeta Nikaj

Lazer Gjergji

